



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



02/ Nr. 7284  
Data: 04.09.2025

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR TË DEDIKUAR PËR GRATË PËR  
DRAFT BUXHETIN PËR VITIN 2026 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2027-2028**

Procesverbali nga Dëgjimi i shtatë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028, të mbajtur me datën **13.08.2025**, duke filluar nga ora **14:00** në **Restaurant "Oslo" – Rr.Lepenci**, me gjithsej 21 pjesëmarrëse, të gjith gra. Nga ekzekutivi, të pranishme ishin Shefja e Kabinetit të Kryetarit, **znj.Liridona Balalzi**, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, **znj.Lindita Ballazhi**, si dhe nga Zyra e Kryetarit dhe disa nga drejtorët/et e drejtorive.

Takimin e kryesoi Shefja e Kabinetit të Kryetarit, znj.Liridona Ballazhi, e cila iu uroi mirëseardhje të pranishmeve, të cilat kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2026, si dhe parashikimi për vitet 2027-2028, ku për rend të punës, kishte:

- 1. Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**
- 2. Diskutimi**

**Liridona Ballazhi thekson:** Për të disatën herë, Komuna e Hanit të Elezit po organizon debat buxhetor të dedikuar vetëm me gratë, sepse sipas praktikave të mëhershme, gjithmonë kanë munguar propozimet e grave nëpër debate buxhetore, dhe arsyeja e organizimit të debateve vetëm e vetëm për gratë ka nxitur pjesëmarrje të grave dhe shprehjen e kërkesave, propozimeve dhe rekomandimeve të tyre drejtpërdrejt tek institucionet lokale, ku për të mos thënë të gjitha, shumica e projekteve, kërkesave apo rekomandimeve të dhëna në këto debate vetëm me gratë kanë arritur të futen në draft buxhet, por edhe të realizohen kërkesa të ndryshme që jo domosdoshmërisht janë investime kapitale. Ne sot, gjithashtu do të bëjmë prezentimin e draft buxhetit komunal për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028, e më pas do të avzhdohet me diskutimin, ku edhe do të mbahet procesverbal ku do të shënohen të gjitha diskutimet, kërkesat dhe më pas do të ahrohen raporti me të gjitha kërkesat dhe statusin e asaj kërkesë. Për detaje më të hollësishme të draft buxhetit, fjalën ia jap drejtoreshës, Lindita Ballazhi.

- 1. Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmet për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor, dhe i inkurajon që në këtë debat të shprehin çdo gjë që ato e shohin të arsyeshme.

**Lindita Ballazhi thekson:** Buxheti në disponim për vitin 2026 është 4,234,682 €, prej tyre e dedikuar për investime kapitale është shuma 891,140 €, pra këtë shumë ne mund ta shpenzojmë për projekte të ndryshme kapitale, ku para vetes keni fletushkat e përgatitura nga Instituti GAP, të cilën janë të listuara projektet kapitale, ku ka projekte që barten vit pas viti, por edhe projekte tjera të propozuara nga qytetarët. Nëse keni ndonjë propozim, ne jemi të hapur për t'i dëgjuar dhe më pas këto do të dërgohen për diskutim dhe shqyrtim me grupin punues për hartimin e draft buxhetit.

## 2. Diskutimi

**Liridona Ballazhi:** Pas prezantimit nga drejtoresha, unë e hap diskutimin për të pranishmit. Nëse keni ndonjë sugjerim, rekomandim, kërkesë për buxhetin e vitit 2026.

**Vahide Shkreta:** Ne që kemi kontrolle në Ferizaj për sëmundjen e rëndë, duhet me shku deri në 2-3 për me caktu terminin për një CD, dhe me mujt me na e lanë një numër për me caktu termine e mos me prit me muaj veç për me lexu një CD se situata jonë ndryshon, ku unë shpesh personalisht jam përball edhe me kontrolle dhe mosbesim se jam me sëmundje, sepse dhe socialin ma ka ndërprerë, e gjithashtu asnjë në familje nuk jemi të punësum dhe tu udhëtu ka 2-3 herë veç me caktu termin e masanej prapë mos me t'pranu është shumë shtrenjtë për mu që me e përballu. S'paku ta kemi një numër kontakti me to, dhe terminet të mos na i zgjasin shumë se qysh e thash situata jonë ndryshon në çdo moment.

**Liridona Ballazhi:** Unë e marr si kërkesë dhe bashkë me drejtoreshën e shëndetësisë do të shohim mundësinë e kontaktimit me stafin në Ferizaj që mos me i pas ju këto telashe.

**Igballe Thaçi Bushi:** Për me u ndërlihd fillimisht te çështjet e shëndetit, unë kam pa që në ambullantën tonë janë kushtet, mirpo nuk kam pa që ka dikush mjek ose dikush që i lexon ultrazanimin. Na po i bojme incizimet këtu, por po duhet me shku që rezultatet me i lexu në Ferizaj dhe kisha kërku që me mujt me u siguru kuadro me u lexu edhe këtu. Një çështje tjetër është mungesa e ujit të pijshëm, ku gati 2 muaj nuk jemi ujë nga ujësjellësi, nashta edhe ka po unë as nuk e di kur ka reduktime edhe jo çdo herë po munjmë me e nxan kur ka ujë, por edhe furnizimin me bunar që e kemi ka fillu me u pakësu sasia, e kuptoj shkakun i thatësisë, po menoj që duhet me u gjet një zgjidhje që me pas ujë, me u investu në këtë drejtim. Një shqetësim tjetër, mungesa e ndriçimit prej te La Terrasa deri te kufini, aty ka edhe mungesë, po edhe aty ku ka ndriçimi osht shumë i ulët, sidomos te pjesa e vendkalimit të këmbësorëve te rrethi shumë shpesh ne që jemi me vutura po hasim pengesa se nuk shihen këmbësorët kur janë anash rrugës ose kur tentojnë me kalu rrugën, e kërkoj që me u ndryshu qatë ndriçimi, me u shtu para se me ndodh ndonjë fatkeqësi. Një çështje tjetër që më shqetëson, janë qentë endacakë, ku unë kam punëtore në rrobaqepësi dhe duhet me shku me i mor gratë me kerr në mëngjes, njana është prej Dimcës ku ajo s'munet me ardh në kam shkak e qenve endacakë që kur mlidhen janë 15-20 bashkë edhe krijohet frikë për me ardh në punë në kam, pra unë detyrona çdo mëngjes ,e shku me i mor me kerre nëpër shpia në mëngjes punëtoret se bash qat'herë ak shumë qen, e sidomos tash edhe që fillojnë shkollat, munet me ndodh diçka që e sulmojnë naj fmi se vërtet po ka shumë qen që po sillen sidomos në mëngjes.

**Liridona Ballazhi:** Çështjet që i ka parashtrur Igballe janë pothuajse çështje apo shqetësime që i kemi të shpeshta, e sidomos në dëgjimet buxhetore që jemi tu i zhvillu, dhe janë më se normale. Shkurtimisht për me tu përgjigj për secilën çështje, aty ku kam informacione ma shumë. E para, ne jemi vazhdimisht në kontakte me kompaninë Sharrcem lidhur me përkrahjen e projekteve për komunitetin. Me ta kemi bashkëpunu jashtzakonisht shumë në fushën e shëndetësisë, ku siç e dini veçse momentalisht jemi duke i ofru shërbimet e kardiologjisë përmes përkrahjes së Sharrcem-it, gjithashtu më herët Sharrcem e ka përkrahur komunën edhe me shtimin e stafit në QKMF e poashtu edhe dhurimi i një autoambulance. Përveç kësaj, ne si komunë akoma jemi në implementim të projektit me Islamic Relief ku janë shtuar kuadrot në QKMF, e poashtu edhe Poliklinika “Pleura” veçse prej pothuajse nga fillimi i vitit me vetë vullnet po jep shërbime falas në QKMF. Kjo mënyrë e bashkëpunimit do të avzhdohë edhe më tutje, ku si informacion i fundit është se ne veçse para një jave kemi përfituar donacion një pajisje të një aparature që përdoret për diagnostifikim të kancerit të gjirit. Siç e the edhe ti, kemi kushte në QKMF, pajisje, është investu edhe në infrastrukturë, megjithatë qynim i joni për vitin e ardhshëm në shëndetësi do të jetë shtimi i kuadrove të reja, por pse jo edhe trajnimi dhe avancimi në dije i kuadrove aktuale. Me buxhetin për vitin 2026, në drejtori të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale pritet që të hapen fillimisht 4 pozita të reja, një fizioterapist, një logoped, një psikolog dhe një punëtor social. Megjithatë, ne kërkesën për radiolog apo onkolog do ta bëjmë avzhdimisht tek donatorët, derisa të aprovohen edhe si pozita të përhershme, por si zgjidhje momentale do të jetë përmes doantorëve dhe bashkëpunimeve. Poashtu lidhur me shtimin e kapaciteteve të ujit, ne si komunë jemi në bisedime me donatorët, për studim të fizibilitetit për burime të reja të ujit brenda territorit të Hanit të Elezit, apo për investime në burimet aktuale që do të rrisnin kapacitetet e ujit, por këtu shqetësim vazhdon të mbeten kycjet ilegale apo keqpërdorimet, sepse po të përdorej me masë dhe sipas nevojës, nuk do të ishin problemet aq të theksuara, ku zona të ndryshme mebsin me javë të tëra pa furnizim, edhe lidhur me këtë shqetësim, organet kompetente po vazhdojnë vizitat në terren për eliminimin e këtyre kycjeve ilegale. Ndërsa shqetësimin për ndriçimin e ulët tek rruga “Adem Jashari” ne do ta shënojmë dhe do ta paraqesim te Drejtoria e shërbimeve publike, ku ato veçse janë në procedura tenderimi për mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe do të shiehet mundësia që kjo kërkesë të realizohet edhe brenda këtij viti. Si dhe çështja e qenve endacakë, fatkeqësisht ne si institucion lokal e kemi jashtë fushës së veorit, sepse me këtë çështje merret ekskluzivisht Qeveria e Kosovës, pra niveli qendror, dhe pavarësisht shumë kërkesave tona si komunë drejtuar nivelit qendror lidhur me këtë shqetësim, ku kemi pas edhe rast të caktuar që qentë kanë sulmuar edhe një fëmijë, fatmirësisht pa pasoja fizike, por që ai sulm ka shkaktuar absolutisht shqetësim tek vajza dhe tek familajrët e saj, mirëpo fatkeqësisht nuk është marrë asnjëherë asnjë veprim lidhur me këtë çështje mjaft shqetësuese, mirëpo edhe po të jepej mundësia që komuna të ndërmarrë ndonjë projekt, siç janë edhe strehimoret e qenve, për buxhetin tonë komunal kjo është e papërbalueshme. Gjithsesi çdo kërkesë apo shqetësim tëndin ne do ta shënojmë dhe do ta shqyrtojmë.

**Drita Prenku:** Unë kisha kërku që neve të na mundësohet që të bëhet biokimia e gjakut dhe tumormarkerat, sepse qysh e thanë edhe para meje për çdo analizë për çdo lexim rezultatesh po duhet me shku në Ferizaj e shpesh edhe jemi kthyer pa na e kry shërbimin, ku edhe termine po na caktojnë mas shumë muajve. Si dhe me mujt radiologu një herë në javë s’paku me ardh që mos me udhëtu na çdo herë në qytete tjera.

**Liridona Ballazhi:** Për çdo kërkesë që ndërlidhet me çështjet shëndetësore, ne do ta kemi prioritet dhe do ta shqyrtojmë mundësinë e realizimit të këtyre kërkesave.

**Myvedete Vila:** Unë e kam fmin në shkollë në Ferizaj dhe një shqetësim që e kemi është ajo po ka orë edhe masdite dhe deri në Kaçanik po kanë me çka me ardh, por prej Kaçanikut për në Han të Elezit s'po kanë e po duhet vazhdimisht me shku me i marr. Kisha kërku që me pa mundësinë me e shtu një linjë prej Kaçanikut në Han të Elezit në orën 20:00, që fmit me pas me u kthy, se përditë po na kushton si familje transporti i fmise për me is jell prej Kaçanikut në Han të Elezit, ose pse jo me u qel një stacion autobusi ku fmit kishin pas transport ma shumë.

**Liridona Ballazhi:** Padyshim një stacion autobusash do të ishte zgjidhje e madhe, ku sipas informacioneve që kam një nga kriteret është hapësira e mjaftueshme për një stacion të tillë, operator të licensuar, etj etj. Ne kërkesën për mundësinë e n një stacioni autobusësh e kemi bërë qysh në vitin 2022, por na është kthyer negativisht, andaj edhe operojmë me pagesën për transportin për nxënës në lokalitet gjithashtu edhe në Kaçanik, duke u bazuar te Rregullorja në fuqi. Ne në aspekt shoqëror, mund të bëjmë kërkesa tek operatorët aktual që ofrojnë shërbime transporti nga apo në drejtim të Hanit të Elezit, por prapë mbetet sipas itineratit të tyre. Gjithsesi ne e diskutojmë edhe këtë çështje.

**Lumturije Bushi:** Unë punoj me The HALO Trust Kosova që merret me deminimin e minave. Ne e falënderojmë KRYeatin që ka tregu kujdes të veçantë dhe na ka ofruar përkrahje. Edhe në diskutime me Kryetarin, e kemi shorehë që neve tash na duhet me vepru në zona pak am t'thella për me e kry punën tonë. Dhe ka zona që duhet me u hap rruga, sidomso kah rruga për në Neçavc, ku ne kemi marrë edhe zotimin e kryetarit se kjo kërkesë do të realizohet, pra aty mjafton vetëm si trase me u hap rruga, sa me pas me kalu për me shku në zonën ku kemi me vepru.

**Liridona Ballazhi:** Pavarësisht që veçse janë dhënë zotimet për realizimin e kësaj kërkesë, duke paur parasysh ndjeshmërinë e punës që ju e veproni, po e shënojmë si kërkesë dhe do të shqyrtohet edhe kjo nga grupi punues.

**Ardita Suma:** Unë jam nxënëse që ndjek mësimin në Ferizaj dhe është barrë shumë e amdhe për familjen transporti i përditshëm për me ndjek procesin mësimor. Unë s'kam përfitu asnjëherë bursa apo përkrahje financiare, por a ekziston mundësia që me m'përkrah në këtë drejtim, sado pak me u lehtësu barrae familjes për shpenzimet e transportit.

**Lindita Ballazhi:** Komuna e Hanit të Elezit subvencionon kategori të ndryshme, shembull janë bursat e studentëve, janë subvencionuar shoqata të dnryshme, gjithashtu subvencionohet ehed epersonat me sëmundje të rënda sipas kërkesave, por edhe studentë apo nxënës që janë jashtë bursave të studentëve, dhe pas shqyrtimit të kërkesave, merret vendimi për subvencionim, prandaj çdo kush mund të parashtrojë kërkesa për mbështetje dhe sipas shqyrtimit, edhe merret vendimi për subvencionim apo mossubvencionim.

**Lumturije Bushi:** Unë e kam edhe një kërkesë, lidhur me uniformat e nxënësve, ku ne kemi vet fëmijë në shkollë dhe shpesh me këto uniforma aktuale që i kanë, po bullizohen për veshjet. Unë kisha propozu që shkollat në Han të Elezit të jenë standarde, ku secili të ketë këmisha dhe

pantallona dhe të jenë të njëjta për të gjithë. Gjithashtu menoj se uniformat e tilla e kishin parandalu veshjet joadekuate të nxënësve në shkolla, pra me pas ka një uniformë unike për të gjithë njëjtë, këmishë, maicë apo duks apo çkado të përshtatshme për stinët e ngrohta dhe të ftohta.

**Liridona Ballazhi:** Ne do t'i marrim të gjitha rekomandimet tuaja, do t'i shënojmë dhe do t'i shqyrtojmë. A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Mbledhja përfundoi në ora 14:45.

**Procesmbajtësja**

**Liridona Ballazhi**

